

## BIO SHQIP

Dr. Albana (Ndreu) Halili, aktualisht lektore pranë Universitetit 'Aleksandër Moisiu' (UAMD) në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, ka përfunduar studimet e nivelit bachelor në Shkurt 2003 në Departamentin e Inxhinierisë Kimike dhe më pas ka përfunduar me sukses studimet e nivelit Master Shkencor, MSc (Shkurt, 2007) dhe doktoraturë, PhD (Korrik, 2011) në fushën e Bioteknologjisë në Middle East Technical University/Turqi. Fusha e kërkimit të saj bazohet në biomateriale dhe inxhinierinë e indeve, shkenca e materialeve, disa aspekte të nanoteknologjisë dhe së fundmi në imazherinë biomedikale. Gjatë studimeve të saj pasuniversitare, Dr. Halili ka qenë pjesë e dy projekteve kërkimore europiane, FP6 (Expertissues dhe BioPolysurf) si kërkuese dhe gjithashtu tema e saj e doktoraturës (Collagen-based meniscus tissue engineering: Design and Application) e realizuar në bashkëpunim me kompaninë Ars Arthro Co., është financuar si projekt SANTEZ nga Ministria Turke e Industrisë dhe Biznesit pasi ishte një kërkim që do të rezultonte në prodhimin e një produkti si meniskus artificial. Dr. Halili ka qenë gjithashtu pjesë e komisionit drejtues të një projekti TEMPUS (2011-2014) dhe pjesë e projektit COST Action MP1206. Gjatë experiencës së saj të mëparshme të mësimdhënies, ka dhënë kurset Kimi e përgjithshme, Shkenca e materialeve, Metodat Kërkimore, Hyrje në nanoshkencë dhe nanoteknologji dhe Bioinformatikë. Prej tre vitesh, në UAMD, Dr. Halili drejton lëndët Metoda Kërkimi dhe Menaxhim Projekti. Albana është autore dhe bashkëautore e punimeve shkencore botuar në revista ndërkombëtare kryesisht në fushën e Biomaterialeve dhe Inxhinierisë së Indeve dhe së fundmi në Prosesimin e Imazheve për qëllim aplikimi biomedikal. Ajo është gjithashtu anëtare e disa shoqatave shkencore europiane dhe pjesë e bordeve editoriale të disa revistave dhe konferencave ndërkombëtare.

## **BIO ENGLISH**

Dr. Albana (Ndreu) Halili is a lecturer at Aleksander Moisiu University (UAMD) in the Department of Information Technology. She got her bachelor degree in February 2003 from the department of Chemical Engineering and then completed her MSc (February, 2007) and PhD (July, 2011) in the field of Biotechnology at Middle East Technical University/Turkey. Her research focuses on biomaterials, tissue engineering, materials science, certain aspects of nanotechnology and recently biomedical imaging. During her MSc. and PhD studies Dr. Halili has had experience as a researcher with some FP6 EU projects (Expertissues and BioPolysurf) and her PhD study (Collagen-based meniscus tissue engineering: Design and Application), which was accepted as a SANTEZ project, was funded by the Turkish Ministry of Industry and Commerce and was done in collaboration with Ars Arthro Co. a biomaterials-based research and development company. Dr. Halili was also the steering committee member of a TEMPUS project and a member of COST Action MP1206. Regarding her teaching experience, previously she has taught General Chemistry, Materials Science, Research Methods, Introduction to Nanoscience and Nanotechnology and Bioinformatics courses previously. In the last three years she is teaching Research Methods and Project Management courses at UAMD. Albana is the author and co-author of many research papers, mostly in the field of Biomaterials and Tissue Engineering and recently in Image Processing for medical applications. She is a member of many scientific European societies and editorial boards of some international journals and conferences.